



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



01-244

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031, 21.06.2016, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 14, 15, 19, 20 dhe 21 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, dt.31.05.2012, nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Vendimit 05 Nr. 350/02-246903/19/01 DT. 25.03.2021 për caktimin e Kushteve Ndërtimore dhe Vendimit 05 NR. 350/03-237331/21 DT. 30.11.2021 për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të kushteve ndërtimore, duke vendosur sipas kërkesës me **05 nr.351/02-43413/22 dt. 28.02.2022**, të aplikuesit /pronarit **“Pozhegu Brothers” Sh.p.k.** me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr.811251032 Prishtinë, me adresë Rr.Muharrem Fejza, blloku C11/A1, Lok.4. Prishtinë, për lejimin e ndërtimit të ndërtesave shumë banesore afariste “B15/F1” dhe “B15/F2”, të emëruar “Mata Hill”, në kuadër të bllokut urban “B15”, Tërësia “B” e Planit Rregullues “Mati 1” dhe PZHU-së, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me dt.16.12.2022, merr këtë:

#### **V E N D I M** **PËR LEJIMIN E NDËRTIMIT**

**I. I LEJOHET** pronarit/investitorit **“Pozhegu Brothers” Sh.p.k.** me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr.811251032 Prishtinë, me adresë Blloku CII/A4, Nr.6.Lagja Mati1. Prishtinë, sipas kërkesës për leje ndërtimore **05 Nr.351/02-43413/22 dt.28.02.2022**, ndërtimi i ndërtesave shumë banesore afariste “B15/F1” me etazhitet 2B+S+P+7 dhe “B15/F2” me etazhitet 2B+S+P+8, të emëruar si kompleksi “Mata Hill”, në bllokun urban “B15”, Tërësia “B” e Planit Rregullues “Mati 1” dhe PZHU-së, Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.1788-0( e krijuar me bashkimin e parcelave kadastrale 588-19 dhe 588-17) ZK.Matiçan.

**II.** Hartimin e projektit kryesor për ndërtesat investive nga pika I e këtij Vendimi, e ka bërë N.N.SH. "Pozhegu Brothers"Sh.p.k, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811251032, me projektues:

Faza e Arkitekturës: Krenare Kadriu, Ma.Arch, FORTESË FERIZI, MA.Arch;

Faza e Ndërtimtarisë: Zijadin Guri, Dr.Sc.ndërt.;

Faza e Hidroteknikës: Arban Shala, Inxh.dip.hidroteknikës;

Faza e Mekanikës: Agron Pajaziti, Dr.Sc.Mek. Prishtinë

Faza e Elektrikes: Dukagjin Ramqaj, Msc.i instalimeve elektrike;

Elaboratin e Organiz. te Punishtes: Krenare Kadriu, Ma.Arch, Fortesë Ferizi, Ma.Arch;

Elaboratin e Mbrojtjes nga Zjarri: Firma Projektuese: “Sigma Construction” me nr. të licencës 116;

Elaborati i gjeomekanikës: Firma Projektuese: ”Geokos A&A.”O.P. me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr.811340538.;

**III.** Sipas projektit kryesor të prezantuar, sipërfaqja e tërësishme ndërtimore e ndërtesave shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesave “B15/F1” dhe “B15/F2 (Kompleksi “Mata Hill”)”, e lejuar për ndërtim, është  $S=14,666.1 m^2$ , prej tyre  $10,011.02m^2$  mbi tokë dhe  $4,655.08m^2$  nën tokë;

Destinimi, nivelet me kuota relative dhe absolute, përmbajtja dhe sipërfaqet e ndërtesës "B15/F1 me etazhitet 2B+S+P+7, me sipërfaqe totale prej 5,773.02m<sup>2</sup> nga kjo 1,615.5m<sup>2</sup> nëntokë dhe 4,157.52m<sup>2</sup> mbi tokë, është:

Bodrumi -2, me sipërfaqe totale për S=684.16m<sup>2</sup>, me destinim dhe përmbajtje: Garazha, Kthina teknike dhe Depo;

Bodrumi -1, me sipërfaqe totale për S=684.16m<sup>2</sup>, me destinim dhe përmbajtje: Garazha, Kthina teknike dhe Depo;

Sutereni, me sipërfaqe totale për S=494.36m<sup>2</sup>, me destinim dhe përmbajtje: Afarizëm dhe Depo;

Përdhesa, me sipërfaqe totale S=434.21m<sup>2</sup>, me destinim dhe përmbajtje: Banim;

Kati I-rë deri në Katin e VII-të, me sipërfaqe të etazhës nga S=496.59m<sup>2</sup> total S=3,476.13m<sup>2</sup>, me destinim dhe përmbajtje të etazhës: Banim

Destinimi, nivelet me kuota relative dhe absolute, përmbajtja dhe sipërfaqet e ndërtesës "B15/F2 me etazhitet 2B+S+P+8, me sipërfaqe totale prej 8,893.08m<sup>2</sup> nga kjo 3,039.58m<sup>2</sup> nëntokë dhe 5,853.5m<sup>2</sup> mbi tokë, është:

Bodrumi -2, me sipërfaqe totale për S=1,296.97m<sup>2</sup>, me destinim dhe përmbajtje: Garazha, Kthina teknike dhe Depo;

Bodrumi -1, me sipërfaqe totale për S=1,436.31m<sup>2</sup>, me destinim dhe përmbajtje: Garazha, Kthina teknike dhe Depo;

Sutereni, me sipërfaqe totale S=612.60m<sup>2</sup>, me destinim dhe përmbajtje: Afarizëm dhe Depo;

Përdhesa, me sipërfaqe totale S=614.08m<sup>2</sup>, me destinim dhe përmbajtje: Afarizëm dhe Banim;

Kati I-rë deri në Katin e VIII-të, me sipërfaqe të etazhës nga S=616.64m<sup>2</sup>, total S=4,933.12m<sup>2</sup> me destinim dhe përmbajtje të etazhës: Banim

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumentacioni ndërtimor, plani i lokacionit me ndërtesën sipas vijës rregullative dhe asaj ndërtimore të përshkruar në situacionin grafik si dhe Dispozita Urbanistike e ndërtesës me parcelën kadastrale në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori, e i cili do të shërbejë si bazë për relievimin gjeodezik të ndërtesës nga pika I. e këtij Vendimi.

V. Poseduesi i Lejes Ndërtimore, është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies në dorëzim të këtij Vendimi të lejes ndërtimore apo me kërkesë t'i drejtohet këtij organi për vazhdimin e vlefshmërisë edhe për një (1) vit, para skadimit të afatit;
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim, me informatat e mëposhtme:
  - informatën mbi Lejen Ndërtimore;
  - informatat mbi projektuesin;
  - informatat mbi kontraktuesin; dhe
  - prezantimin grafik të dukjes së ndërtimit.
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
  - një kopje të këtij Vendimi;
  - një kopje të kontratës së lidhur ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit, nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
  - një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit, që janë nënshkruar ose vulosur si "I MIRATUAR" nga organi kompetent- projektin kryesor me të gjitha fazat;
  - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
  - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore, përshkrim të

- problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur, si dhe protokollet e miratuara, të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit.
- T'i dorëzojë njoftim inspektoratit të organit kompetent, për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
  - Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet, siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
  - Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor, të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor, të miratuara nga projektuesi, përveç në rastet kur:
    - ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
    - ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% (dy përqind) dhe 0,1 metër (zero presje një metër), por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
    - ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
  - Të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga “Marrëveshja për ndërtimin e infrastrukturës nga ana e Investitorit”, ref. 05 nr. 351/02-43413/22 dt.01.04.2022, e lidhur në mes Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës dhe investitorit “Pozhegu Brothers” Sh.p.k. me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr.811251032 Prishtinë, me adresë Rr.Muharrem Fejza, blloku C11/A1, Lok.4. Prishtinë;
  - Të përmbushë obligimin mbi pagesën e shumës së kështit të dytë, të tretë dhe të katërt , të përcaktuar sipas pikës II të aktit administrativ “Aktvendim për caktimin e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës”, 05 NR. 351/02-164047/21 DT. 11.08.2022, dhe garancioneve për kështin e II-të, të III-të dhe të IV-të të prezantuar nga kompania e sigurimeve Elsig” me nr.107855, 107854 dhe 107853;
  - Të aplikojë te ky organ për Certifikatë të Përdorimit, pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

## A r s y e t i m

Pronari/investitori “Pozhegu Brothers” Sh.p.k. me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr.811251032 Prishtinë, me adresë Rr.Muharrem Fejza, blloku C11/A1, Lok.4. Prishtinë, në bazë të kërkesës me **05 Nr.351/02-43413/22 dt.28.02.2022**, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lejimin e ndërtimit të ndërtesave shumë banesore afariste “B15/F1” me etazhitet 2B+S+P+7 dhe “B15/F2” me etazhitet / 2B+S+P+8, të emëruar Kompleksi “Mata Hill”, të bllokut urban “B15”, Tërësia “B” e Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në lokacionin e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij Vendimi.

Bashkangjitur me kërkesë pronarët dhe investitori kanë prezantuar këtë dokumentacion:

- *Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit për parcelën kadastrale nr.1788-0, ZK.Matiçan në pronësi të “Pozhegu Brothers”Sh.p.k. dhe me destinim “Tokë Ndërtimore”.*
- Informatën nga Plani Rregullues “Mati 1” dhe PZHU, me nr.1862 dt.12.09.2018;
- Vendimin për Miratimin e Ndryshimit të Kushteve Ndërtimore me 05 Nr.350/03-237331/21 dt.30.11.2021, të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit;

- Vendimin e Kushteve Ndërtimore me 05 Nr.350/03-246903/19/01 dt.25.03.2021, të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit;
- Projektin kryesor (3 kopje identike fizike dhe digjitale);
- Incizimin gjeodezik të punuar nga gjeodet i licencuar Burim Halilaj, me nr.të Lic.195;
- “Marrëveshja për ndërtimin e infrastrukturës nga ana e Investitorit”, ref. 05 nr. 351/02-43413/22 dt.01.04.2022, e lidhur në mes Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës dhe investitorit “Pozhegu Brothers”Sh.P.K..Prishtinë;
- Proven mbi pagesën e kështit të parë mbi pagesën e taksës administrative dhe tarifës së densitetit, të llogaritur sipas Aktvendimit 05 NR. 351/02-164047/21 DT. 11.08.2022, e të paguar në bankën “BPB Bankë , Prishtinë , në shumën 50,719.59euro.
- Deklaratën e Garantuesit nga kompania e sigurimeve "Elsig" me nr.107855, 107854 dhe 107853, cili garanton për pagesën me kohë të obligimeve që rrjedhin nga Aktvendimi 05 NR. 351/02-164047/21 DT. 11.08.2022, si në vijim: kështi i dytë, në vlerën prej 42,265.075 €, i cili skadon me 26.04.2023, kështi i tretë, në vlerën prej 42,265.075 €, i cili skadon me 26.10.2023 dhe kështi i katërt, në vlerën prej 33,812.06 €, i cili skadon me 26.04.2024, të prezantuar përmes kërkesës 05 Nr.351/02-43413/22/2 dt.27.10.2022 dhe 05 Nr.351/02-164047/21/2 dt.14.10.2022;
- Çertifikatën e regjistrimit të biznesit të Pozhegu Brothers”Sh.p.k. me nr. të biznesit nr.811251032;
- “Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik”, nr. 979 dt. 10.02.2022, lëshuar nga Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A.- “KEDS;
- “Dhënia e kushteve teknike“, nr. 268739 dt. 04.02.2022, lëshuar nga Kompania e Ujësjetillësit Rajonal "Prishtina" sh.a.;
- Kopje e “Pëlqim për gropim në “Mati 1”, nr. 129/1 dt. 01.02.2022, lëshuar nga Termokos Sh.A.;
- “Dhënia e pëlqimit nga Telekom i Kosovës” nr. 03-567/200 dt.23.02.2022, të lëshuar nga Telekom i Kosovës sh.a.;
- “Pëlqim në dokumentacion investivo teknik” mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri me për ndërtesat F1 dhe F2, me numër evidentues 1686/22 dt.07.04.2022, të lëshuar nga Agjencia e Menagjimit Emergjent;
- Vendimin e lejes Mjedisore Komunale me 04 Nr.352/10-43383/22 dt.09.08.2022;
- Kopjet e dokumenteve të identifikimit;

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në fazën e shqyrtimit të kërkesës 05 Nr.351/02-43413/22 dt. 28.02.2022, dhe dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, të prezantuar bashkë me kërkesën për leje ndërtimore, ka konstatuar se aplikuesit: **Bedri Sadiku, Gani Havolli, Naser Lala, Lulzim Ibrahim, Idriz Visoka, Lulzim Havolli, SH.P.K.”Pozhegu Brothers”,Hetem Mustafa, Selim Musa, Genti Lala, me investitor:”Pozhegu Brothers”Sh.P.K.,Prishtinë**, me kërkesën 05 nr.350/02-246903/19/01 DT. 29.07.2020, kanë kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit afaristo banesor me ndërtesa shumë banesore&afariste, në kuadër të bllokut urban " bllokut urban “B15”, të tërësisë “B”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë. Kjo Drejtori duke vendosur sipas kërkesës ka caktuar Kushtet Ndërtimore 05 Nr. 350/02-246903/19/01 DT. 25.03.2021, për lokacionin e përkrahur në pikën I. të dispozitivit të këtij Vendimi.

Pas paisje me Kushte Ndërtimore, investitori ”Pozhegu Brothers” Sh.P.K., Prishtinë, me anë të kërkesës 05 Nr. 350/03-237331/21 dt.04.11.2021, ka kërkuar Miratimin E Plotësimit Dhe Ndryshimit Të Vendimit Të Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-246903/19/01 DT. 25.03.2021, duke kërkuar kështu mundësimin e zhvillimit nëpër faza, për shkak madhësisë së bllokut të planifikuar dhe kërkesës së palëve të interesit, duke mos ndryshuar zgjidhjen urbane, parcelat e trajtuara me kushte ndërtimore

dhe sipërfaqet ndërtimore të miratuara me kushtet e lartcekura. Duke propozuar si fazë të parë të zhvillimit ndërtesat F1 dhe F2 dhe Fazë e dytë F3 dhe F4. Kjo Drejtori me anë të Vendimit ka 05 NR. 350/03-237331/21 DT. 30.11.2021, ka miratuar kërkesën për plotësim ndryshim.

Drejtoria e Urbanizmit, në procedurën për shqyrtimin e kërkesës për leje ndërtimore dhe duke u bazuar në nenin 23 të Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenin 17 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenin 10 dhe 11 të "Rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës", kjo Drejtori, me shkresën "Kërkesë dhe Akt përcjellës" 05 Nr. 351/02-43413/22 dt. 07.03.2022, ka dërguar dokumentacionin e nevojshëm në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e marrëveshjes për pagesën e tarifës rregullative të infrastrukturës, dhe bazuar në këtë, është nënshkruar "Marrëveshja për ndërtimin e infrastrukturës nga ana e Investitorit" me ref. 05 nr. 351/02-43413/22 dt. 01.04.2022, e lidhur në mes Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës dhe palës "Pozhegu Brothers" Sh.P.K., Prishtinë, ku sipas kësaj marrëveshjeje, është caktuar shuma totale e Investimit e që është 135, 688.00 euro, shuma totale e pagesës së tarifës për rregullimin e Infrastrukturës për F1 dhe F2, është caktuar në vlerë prej 59,402.37m<sup>2</sup> ndërsa mbetja prej 76,285.63euro do të zbatohet në kërkesat e tjera për leje ndërtimore në kuadër të bllokut B15, të Planit Rregullues "Mati 1", Prishtinë.

Dokumentacioni ndërtimor/projekti kryesor, në fazën e trajtimit, është shqyrtuar dhe kontrolluar edhe nga zyrtarët përkatës për fazat e caktuara të projektimit (për strukturë, elektrikë, ujësjellës dhe kanalizim, makineri, komunikacion, etj.), të cilët, pas kontrollit të njëjtit dokumentacion, kanë konfirmuar rregullsinë e tij, përmes formularëve "Lista Kontrolluese për Shqyrtim të Kërkesës për Leje Ndërtimore për Kategorinë e II-të", konkretisht është dhënë pëlqim në dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor të prezantuar.

Kjo Drejtori, bazuar në "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01-434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, kërkesit të lartcekur me Aktvendimin 05 NR. 351/02-164047/21 DT. 11.08.2022, i ka caktuar shumën dhe mënyrën e llogaritjes së taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit, në shumën prej 169,060.30€, me mundësi pagese në katër këste si në vijim: kësti I në vlerën prej 50,718.09€ ose 30% e vlerës totale, kësti II në vlerën prej 42,265.075€ ose 25% e vlerës totale, kësti III në vlerën 42,265.075 € ose 25% e vlerës totale dhe kësti i IV-të në vlerë prej 33,812.06euro ose 20% e vlerës totale. Për këstin e parë të caktuar është prezantuar pagesa e bërë në "BPB Bankë, Prishtinë, në shumën 50,719.59euro, ndërsa për këstin e II-të, të III-të dhe të IV-të ka prezantuar garancionet nga kompania e sigurimeve "Elsig" nr.107855, 107854 dhe 107853, cili garanton për pagesën me kohë të obligimeve që rrjedhin nga Aktvendimi 05 NR. 351/02-164047/21 DT. 11.08.2022, si në vijim: kësti i dytë, në vlerën prej 42,265.075 €, i cili skadon me 26.04.2023, kësti i tretë, në vlerën prej 42,265.075 €, i cili skadon me 26.10.2023 dhe kësti i katërt, në vlerën prej 33,812.06 €, i cili skadon me 26.04.2024, të prezantuara përmes kërkesës 05 Nr.351/02-43413/22/2 dt.27.10.2022 dhe 05 Nr.351/02-164047/21/2 dt.14.10.2022;

Bazuar në kërkesë, Drejtoria e urbanizmit Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm- Sektori i Mjedisit dhe Efiçencës, me Vendimin 04 Nr.352/10-43383/22 DT.09.08.2022, për miratimin e kërkesës për Leje Mjedisore Komunale për ndërtesat "F1" dhe "F2", ka vërtetuar se investitori ka përmbush kriteret e parapara me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dt. 06.04.2009 dhe UA Nr.17/2015 dt. 01.12.2015;

Ky organ, pas shqyrtimit të kërkesës dhe verifikimit të dokumentacionit ndërtimor të prezantuar bashkë me kërkesat 05 Nr.351/02-43413/22 dt.28.02.2022, 05 Nr.351/02-43413/22/1 dt.21.04.2022, 05 Nr.351/02-43413/22/2 dt.28.04.2022, zhvillimit të procedurave paraprake dhe konstatimeve të lartcekura, si dhe bazuar në Ligjin nr. 04/L-110 për Ndërtim, Udhëzimin Administrativ të MMPH-së nr. 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, si dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, ka vërtetuar se investitori ka prezantuar tërë dokumentacionin e nevojshëm e të paraparë me rregullativën ligjore nga lëmi i ndërtimit dhe se i njëjti është në harmoni

me kushtet ndërtimore dhe standardet tjera për llojin përkatës të ndërtimit, si dhe konstatojmë se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Shtojcë:** “Situacioni i ngushtë”; si dhe “Dispozita urbanistike e ndërtesës me parcela kadastrale në Sistemin Koordinativ KOSOVAREF 01”.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimet nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror, MMPHI-së.

**Ky Vendim u shtyp në 5 (pesë) kopje identike fizike dhe i dërgohet:** Kërkuesit/ve; Drejtorisë së Inspektionit; kësaj Drejtorie; në dosje të lëndës **05 Nr.351/02-43413/22 dt.28.02.2022** dhe Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

**Kopje elektronike i dërgohet:** Drejtorisë së Kadastrit; Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**05 nr.351/02-43413/22 dt. 16.12.2022**

Zyrtari,  
Anita Osmani

u.d. Udhëheqëse e Sektorit  
Nazife Krasniqi

DREJTORI,  
Arber Sadiki












Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



## DISPOZITA URBANISTIKE E NDËRTESES ME PARCELË KADASTRALE NË SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01

ZK. Matlçan



Përdhese e planifikuar	32	7515317.08	4723616.48		
1	7515310.76	4723673.53	33	7515316.50	4723616.84
2	7515301.20	4723667.35	34	7515318.12	4723619.46
3	7515301.13	4723667.47	35	7515318.70	4723619.11
4	7515298.79	4723665.96	36	7515321.74	4723624.03
5	7515298.87	4723665.84	37	7515321.86	4723623.95
6	7515298.50	4723665.60	38	7515322.78	4723625.44
7	7515305.81	4723654.29	39	7515322.66	4723625.51
8	7515305.69	4723654.22	40	7515323.29	4723626.53
9	7515306.82	4723652.48	41	7515325.59	4723630.25
10	7515306.94	4723652.56	42	7515332.02	4723640.66
11	7515314.66	4723640.61	43	7515329.55	4723644.48
12	7515313.05	4723638.00	44	7515329.67	4723644.56
13	7515310.87	4723634.21	45	7515328.16	4723646.88
14	7515304.85	4723624.46	46	7515328.05	4723646.80
15	7515304.73	4723624.53	47	7515323.07	4723654.50
16	7515303.59	4723622.70	48	7515322.30	4723654.01
17	7515303.71	4723622.63	49	7515320.62	4723656.60
18	7515295.22	4723608.89	50	7515321.39	4723657.10
19	7515298.09	4723607.11	Bodrumi I planifikuar		
20	7515298.02	4723606.99	51	7515309.80	4723672.91
21	7515300.54	4723605.43	52	7515306.81	4723677.53
22	7515300.61	4723605.55	53	7515287.87	4723665.27
23	7515304.75	4723602.99	54	7515290.86	4723660.66
24	7515304.68	4723602.87	55	7515282.16	4723655.03
25	7515307.21	4723601.31	56	7515282.89	4723653.89
26	7515307.29	4723601.42	57	7515276.73	4723649.90
27	7515307.64	4723601.21	58	7515287.03	4723633.97
28	7515313.71	4723611.03	59	7515293.19	4723637.95
29	7515313.83	4723610.96	60	7515300.68	4723626.40
30	7515314.81	4723612.54	61	7515291.34	4723611.29
31	7515314.69	4723612.61			

Punoi:  
Kushtrim Domaneku.

Anita Osmani.

Legjenda:



Përdhese e planifikuar



Bodrumi I planifikuar  
Vija Ndërmjore sipas PRRU  
Parcelat Kadastrale

Prishtinë: 15.12.2022

